



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 13 korrik .2012
Nr. ref.:RK/276/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rasti Nr. KI 38/10

Parashtruesi

Milan Vasić

Dobratin, komuna Lipjanit

**Kërkesa për vlerësimin e procedurës gjyqësore në Gjykatën Komunale në
Prishtinë
lidhur me lëndën E.nr 34/2001 të datës .19.04.2001 (tejzgjatje e
procedurës)**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare dhe
Ivan Čukalović, Gjyqtar

Parashtruesi i Kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Milan Vasic nga f. Dobrotin komuna e Lipjanit të cilin me Autorizim e përfaqëson avokati z. Ndue Kurti nga Prishtina me banim lagjen Ulpiana A-3,nr.1/1

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes së kërkesës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese nga z. Vasic është Aktvendimi E 54/2001 i dt. 19.04.2001 i Gjykatës Komunale në Prishtinë me anë të së cilit kjo Gjykatë ka aplikuar masën e përkohshme, e më të cilin parashtruesit së kërkesës z. Milan Vasic ia ka ndaluar atij vënien në hipotekë apo shitjen e pronës së paluajtshme, të një banese në lagjen “Bregu i Diellit” në Prishtinë, të përshkruar si Zona Lindore, A-17, kati i parë, nr. 8.

Shkeljet e pretenduara të drejtave të garantuara me Kushtetutë

3. Parashtruesi pretendon që dështimi i Gjykatës Komunale për të ndërmarrë masa të mëtejme shkel të drejtat e paspecifikuara të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe sidomos nenin 6 të KEDNJ(e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm), neni 24 i Kushtetutës së Kosovës (barazia para ligjit) dhe neni 31 e 32 i Kushtetutës së Kosovës (drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe e drejta në mjete juridike)

Baza juridike

4. Neni 113.7 Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në te tekstin e mëtejme Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i dt. 16 Dhjetor 2009 i hyrë në fuqi me 15 janar 2010 (në tekstin e mëtejme referuar si Ligji), dhe neni 29 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme i referuar si rregullorja).

Ankesa e parashtruesit

5. Parashtruesi i kërkesës ka pohuar se Gjykata Komunale në Prishtinë duke nxjerrë Aktvendimin për masën e përkohshme E 54/2001 i dt. 19.04.2001 e me të cilën atij i ka ndaluar vënien në hipotekë, shitjen apo tjetërsimin e paluejtshmërisë-banesë e cila gjendet në Prishtinë në lagjen “ Kodra e Diellit” dhe ka sipërfaqe prej 56,56 m² ,e për të cilin ai pretendon se është pronar i ligjshëm i saj, pa të drejtë ia ka cenuar të drejtat e garantuara me Konventa Evropiane si dhe me Kushtetutën e Kosovës (neni 24,31 e 32).
6. Parashtruesi i kërkesës më tej gjithashtu thekson se procedura para Gjykatës Komunale në Prishtinë ka zgjatur tej mase dhe sipas tij ka kaluar secili afat i arsyeshëm për tu marrë një vendim meritord, gjë e cila e ka dëmtuar atë.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 10.06.2010 Gjykata Kushtetuese pranoi kërkesën e z. Milan Vasic ku dhe e regjistroi atë me nr KI 38/10
8. Më 11.11.2010 me vendimin GJ.R 38/10 Kryetari i Gjykatës caktoj Gjyqtar raportues gjyqtarin Robert Carolan.
9. Të njëjtën ditë Kryetari i Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje Altay Suroy (kryesues) dhe gjyqtarët Amiro Rodrigez e prof. dr. Enver Hasani në cilësi të anëtarëve të kolegjit

10. Gjykata Kushtetuese kishte njoftuar Gjykatën Komunale në Prishtinë më 4 gusht 2011 të për regjistrimin e kërkesës duke kërkuar edhe përgjigjeje me shkrim lidhur me statusin momental të lëndës e cila shqyrtohet në atë gjykatë e që ka të bëjë me kërkesën e parashtruar në Gjykatën Kushtetuese, Një njoftim të tillë Gjykata i ka dërguar edhe përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës.
11. Më 22 .08.2011 Gjykata Kushtetuese ka pranuar përgjigjen me shkrim nga Gjykata Komunale në të cilën shpjegohet kronologjia e lëndës si dhe bashkëngjiten kopjet e vendimeve të marra deri në këtë kohë.
12. Më 27.09.2011 Gjykata Kushtetuese ka pranuar një përgjigjeje shtesë nga Gjykata Komunale në Prishtinë në të cilën Gjyqtari z. Zenel Leku, shpjegon se lidhur me padinë për vërtetimin e pronësisë të ushtruar nga z. Bekë Hasanaj se kjo gjykatë e ka pranuar padinë me 11.05.2001 dhe se gjyqtarja e ngarkuar për këtë lëndë ka mbajtur një seancë me 20.04.2004 dhe ka pezulluar lëndën deri sa të vendos UN-Habitati për të njëjtën çështje ,ndërsa i autorizuari i z. Vasic ka parashtruar përgjigjeje në Padi më 09.02.2009, Gjyqtari leku gjithashtu ka potencuar se për shkak lëvizjeve të shpeshta në këtë gjykatë ai është ngarkuar me këtë lëndë më 30.11.2010 dhe se është i vetëdijshëm për natyrën prioritare të lëndës.
13. Gjykata Kushtetuese ia kishte dërguar këto komente përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës me 27 shtator 2011.
14. Më 03 tetor 2011 Gjykata kushtetuese ka pranuar përgjigjen e përfaqësuesit të z. Vasic, avokatit z. Ndue Kurti lidhur me komentet e Gjykatës Komunale.
15. Më 30 04.2012 Gjykata Kushtetuese ka pranuar Aktvendimin C.nr 500/2001 të datës 16.04.2012 të Gjykatës Komunale në Prishtinë me të cilin kjo Gjykatë shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore për këtë lëndë.
16. Në pikën II të këtij Aktvendimi përcaktohet që sapo aktvendimi të bëhet i formës së prerë ai do ti dërgohet dhomës së posaçme të Gjykatës Supreme për vendosje ndërsa në këshillën juridike të këtij aktvendimi thuhet se kundër tij lejohet ankesa në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së tij.
17. Gjykata Kushtetuese nuk ka informacion nëse Aktvendimi është bërë i formës së prerë dhe i është dërguar dhomës së veçantë të Gjykatës Supreme ose nëse ndonjëra nga palët ka paraqitur ankesë kundër tij.
18. Në seancën e mbajtur me 12.korrik 2012 paneli shqyrtues i rekomandoj Gjykatës në përbërje të plotë njëzëri për papranueshmërinë e kërkesës,

Përmbledhja e fakteve

19. Parashtruesi i kërkesës z. Milan Vasic pretendon se ka pronësinë mbi banesën e cila gjendet e cila gjendet në Prishtinë në lagjen " Kodra e Diellit"-zona e lindjes A-17 kati i I-rë banesa nr 8 dhe që ka sipërfaqe prej 56.56 m² dhe këtë të pretendim të tij ai e mbështet në Kontratën mbi shitblerje të lidhur ne mes tij dhe KXMK "Trepca" D.D të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë vr.nr. 2190/98 dt. 09.06.1998 dhe aneks kontratën vr.nr 413/99 të datës 26.03.1999(të cilat nuk ia ka bashkangjitur kërkesës) dhe të cilat sipas tij atë e deklarojnë si pronar të kësaj banese,sikur që edhe Vendimet e UN-Habitatit HPCC në

Prishtinë DS 000111 dhe DS 000631 të dt. 12.12.2003 dhe vendimi i shkallëssë dytë HPCC DS 000111 dhe DS00031 të dt. 16.11.2006 ia japin të drejtën e posedimit të banesës së sipërpërmendur.

20. Më 19.04.2001 Gjykata Komunale në Prishtinë duke vepruar sipas propozimit të kreditorit z. Bekë Hasanaj nga Prishtina i cili pretendon se ka qenë pronarë i ligjshëm i banesës së sipërpërmendur para se z.Vasic të hynte në te, kishte nxjerrë Aktvendimin E.nr.54/2001 me anë të së cilit ka shqiptuat masën e përkohshme dhe njëkohësisht debitorit z. Milan Vasic nga fshati Dobratin i komunës së Lypjanit i ka ndaluar ngarkimin (vuarjen në hipotekë), shitjen e patundshmërisë ,gjegjësisht legalizimin e kontratës mbi shitblerjen e banesës
21. Sipas fletkëkthesës së Gjykatës Komunale z. Milan Vasic këtë Aktvendim e kishte pranuar më 24.05.2007.
22. Më 29. 05 2007. Z.Vasic ka ushtruar kundërshtim në Gjykatën Komunale në Prishtinë, kundër Aktvendimit të kësaj Gjykate për caktimin e masës së përkohshme E.nr.54/01 të dt.15.04.2001.
23. Më 6.12.2007 Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktvendimin E.nr.54.2001 ka refuzuar kundërshtimin e z. Vasic dhe ka lënë në fuqi Aktvendimin për caktimin e masës së përkohshme me të njëjtin numër të dt. 19.04.2001.
24. Pas aprovimit të kërkesës së dhe caktimit të masës së përkohshme z.Bekë Hasanaj kishte paraqitur padinë kundër të paditurës së parë "Miniera me Flotacion" Kishnicë dhe Novobërdë dhe të paditurit të dytë z. Milan Vasic dhe atë "Për Vërtetimin e pronësisë dhe prishjen e vendimit mbi ndarjen e banesës dhe të kontratës mbi shitblerje" dhe kjo padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë udhëhiqet me shenjen C.nr 500/2001.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

25. Për te qene ne gjendje për te gjykuar mbi Kërkesën e Parashtruesit te kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht te vlerësojë nëse Parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë te cilat përcaktohen ne Kushtetutë.
26. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 te Kushtetutës qe përcakton se:

*"Individët janë te autorizuar te ngrenë **shkeljet nga autoritetet publike te drejtave dhe lirive te tyre individuale, te garantuara me Kushtetute, mirëpo vetëm pasi te kenë shteruar te gjitha mjetet juridike te përcaktuara me ligj.**"*

Gjykata Gjithashtu merr parasysh:

Rregullin 36 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese ku përcaktohet:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
c) Kërkesa është qartas e bazuar:

27. Duke analizuar dokumentacionin e paraqitur në lëndë nga ana e parashtruesit të kërkesës konstatohet se Aktvendimi i fundit i Gjykatës Komunale në Prishtinë me të cilin është refuzuar kundërshtimi i z. Vasic për caktimin e masës së përkohshme është nxjerrë me 6 dhjetor 2007 dhe se sipas shkresave të

deponuara në lëndë së bashku me kërkesën Gjykata nuk gjen fakt se ndaj këtij Aktvendimi të jetë ushtruar mjeti juridik i ankesës i cili palës i është dhënë në udhëzimin juridik si mundësi efektive juridike e cila do të duhej ti drejtohej Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit për procedurë përmbartimore.

28. Gjykata Gjithashtu konstaton se pas nxjerrjes së Aktvendimit C.nr 500/2001 nga ana e Gjykatës Komunale në Prishtinë të datës 16.04.2012 pavarësisht nga fakti nëse Aktvendimi është bërë i formës së prerë dhe lënda i është dërguar për vendim marrje dhomës së veçantë të Gjykatës Supreme ose faktit që ndonjëra nga palët mund të ketë paraqitur ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë .kemi të bëjmë me një rast në pritje të zgjedhjes dhe rrjedhimisht për pasojë ka prapë mos shterjen e mjeteve juridike.
29. Bazuar në këtë fakt Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk e ka përmbush kriterin e pranueshmërisë së shterjes të mjeteve juridike të paraparë me nenin 113.7 të Kushtetutës si dhe rregullit 36.1(a) të rregullores së Punës së Gjykatës kushtetuese.
30. Gjykata dëshiron te theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit te mjeteve juridike është qe t'ua ofrojë autoriteteve vendore, përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar te Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës, do te sigurojë mjet efikas ligjor për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni v. France nr. 25803/94, Vendim i 28 korrikut 1999
31. Gjykata një arsyetim të tillë e kishte aplikuar në gjatë shqyrtimit të mëparshëm të kërkesave e në rastet : KI 55/10 Hamide Osaj në kërkesën për Vlerësim i Kushtetutshmërisë te Aktgjykimit te Gjykatës Supreme te Kosovës, Pkl. nr. 43/2010, i datës 4 qershor 2010 ; Rastin nr. KI 20/10 Muhamet Bucaliu kundër Vendimit te Prokurorit te Shtetit KMLC.nr. 09/10 te 24 shkurtit 2010(vendimi i GJ,Kushtetuese i datës 15 Tetor 2010)
32. Gjykata vëren se sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për një tejzgjatje të "paarsyeshme të procedurës" se "zgjatja e procedurës në shumicën e rasteve varet nga rrethanat specifike të rastit" (shih. Cerin v.Croatia,no 54727000.08.03.2001 par 2), dhe si pasojë të kësaj edhe shkeljes së nenit 6 të KEDNJ (e drejta në gjykim të drejtë dhe kohë të arsyeshme), dhe në rastin konkret z. Vasic si palë kërkuese nuk ka paraqitur ndonjë provë relevante që do të justifikonte pretendimin tij, përpos se ka cekur kohën brenda të cilës nuk është zgjedhë lënda.
33. Me këtë rast Gjykata përkujton se GJEDNJ lidhur me çështjen e tejzgjatjes së procedurës para autoriteteve vendore ka përcaktuar disa kritere siç janë: kompleksiteti i çështjes, sjellja e aplikuesit, sjellja e autoriteteve relevante, rreziku për aplikuesin në procedurë, gjendja(faza) e procedurës etj.
34. Sa i përket kriterit të sjelljes së kërkuesit Gjykata i referohet rastit të GJEDNJ (Darnell v.U.K. 15058/89, 10/04/91). ku është specifikuar" Megjithatë, edhe në qoftë se gjykata kombëtare vetë g është përgjegjëse për vonesat në procedurë, aplikanti duhet të ketë duhet ti ketë kundërshtuar a to në mënyrë që të provojë që për vonesat e panevojshme të mos mund të mbahet përgjegjës ai vetë"

35. Duke parë se z. Vasic nëpërmes përfaqësuesit të vet ligjor, përgjigjja në Padi për lëndën C.nr.500/2001 në të cilin ai kishte statusin e të paditurit e kishte bërë tek më 09.02.2009, ndërsa urgjencën e parë dhe të vetme për përshpejtimin e procedurës lidhur me këtë lëndë e kishte bërë me 15.2009 edhe pse lënda ishte në procedurë nga 11.05.2001 Gjykata konstaton se edhe z. Vasic me mosveprimin e vet ka ndikuar në zgjatjen e procedurës.
36. Duke Gjykuar kriterin e “sjelljes së autoriteteve relevante” Gjykata Kushtetuese vlerëson se Gjykata Komunale në përgjigjen e vet të dt. 27.09.2011 kishte shpjeguar veprimet kronologjike në këtë gjykatë lidhur me këtë lëndë duke potencuar edhe arsyet e vonësive nga të cilat nuk vërehet se procedura në këtë Gjykatë qëllimshëm është zvarritur.
37. Gjykata Kushtetuese megjithatë rikujton se është obligim i të gjitha autoriteteve publike vendore përfshi edhe Gjykatat e rregullta që të marrin vendime meritore lidhur me çështjet e ngritura para tyre dhe atë në përputhje me nenin 31.2 të Kushtetutës së Kosovës se “Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”
38. Në këto rrethana parashtuesi ankesës nuk ka shterur kësaj here. të gjitha mjetet juridike në dispozicion andaj kërkesa është e

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, më 12 korrik 2012, njëzëri:

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim to ti komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20 (4) të Ligjit;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. Dr. Enver Hasani